



Prishtinë, 27 prill 2017
Kodi i ZRRE-së: V_914_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 47 dhe Nenin 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së);
- Dispozitat e Parimeve për përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe taksave të kyçje;
- Vendimin V_908_2017 për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për OSSH;
- Metodologjia e ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes; dhe
- Aplikacionin e KEDS-it për miratimin e tarifave të rregulluara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të dorëzuar më datë 20 prill 2017,

në seancën e mbajtur më 27 prill 2017 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** tarifat për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) për vitin relevant tarifor apo SHTE11, që do të zbatohen nga data 1 prilli 2017.
- II. Struktura e tarifave për OSSH, që do të zbatohet nga data 1 prill 2017, përkatësisht në vitin relevant tarifor SHTE11 është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€/kWh	1.07
10 kV	€/kWh	1.45
0.4 kV	€/kWh	2.15

ARSYETIM

- Rregullatori më datën 20 prill 2017 ka pranuar aplikacionin për tarifa të rregulluara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
 - Rregullatori për vendosjen e tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në faqen zyrtare të saj si në vijim:
 - Raport Konsultativ - Llogaritja e MAR-it të OSSH-së, i publikuar me datën 28 shkurt 2017;
 - Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të OSSH, i publikuar me datën 31 mars 2017;
- III. Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të zbatohet nga KEDS SH.A. për vitin relevant tarifor SHTE11 dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.


Bordi i ZRRE-së:



Krenar Bujupi, u.d kryesues



Arsim Janova, anëtar



Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.